



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:281926

Datë: 03.02.2021

Numri i dokumentit: 01470616

P.nr.643/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtës Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit B. P. nga Vushtrria Rr. “B. B. – A.”, për shkak të veprës penale, Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-se, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr-3919/19 të datës 05.10.2020 (2019:0203735), pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 28.01.2021, në praninë e Prokurorit të shtetit Jovo Radoviq, të pandehurit B. P. pas shpalljes së aktgjykimit me datë 28.01.2021, me datë **03.02.2021** përpiloj, këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: B. P. nga i ati E. e ëma Sh. e vajzërisë G. lindur me datë ... nga Vushtrria Rr. “B. B.A.”, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa pune, i ndarë nga bashkësia jashtëmartesore, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, edhe më parë i gjykuar përmes aktgjykimit P.nr.173/2006.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën me datën 29.11.2019 rreth orës 13:40 në Vushtrri në rr “ Sh.N.” me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, ka organizuar lojëra të fatit, konform dispozitave ligjore për të cilat nuk është lëshuar licenca leje ose koncesioni nga organi kompetent, në atë mënyrë që ne lokalit “ pa firme të regjistruar) pronari i së cilës gjate bastisjes nga Policia u zë se po organizon lojëra të fatit me ç’ rast u konfiskuan aparatet: **1.** Shtëpiza F., nr. serik; **2.** Shtëpiza F., nr. serik ...; **3.** Shtëpiza F. nr. serik ...; **4.** Monitor F. nr. serik ...; **5.** Monitor F. nr. serik ...; **6.** Monitor HP nr serik ...; **7.** Aparati për tiketa T. nr. serik ... **8.** Aparati për tiketa ... nr. serik ...; **9.** Letra për tiketa .nr. serik.; ...**10.** Televizor A. nr. serik ...; **11.** Televizor A. nr.serik ...; **12.** Televizor A. nr serik ... **13.** Televizor A. nr serik ...; **14.** Televizor A. nr serik ...; **15.**T. HP nr . serik ... **16.**T. HP nr. serik ...; **17.** T. HP.nr serik ...; **18.** S. O. nr. serik ...; **19.** Te hollat ... euro; **20.** Tikitat e shtypura pa numër serik.

- Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par 2 të KPRK-së

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 59, 69, 70 dhe nenit 294 par.2 të KPRK-së si dhe nenit 115, 283, 365, dhe 450 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: Burim Pllana i shqipton **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj të cilin dënim do ta mbajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Ky dënim me burgim me pëlqimin e te pandehurit me rastin e shpalljes së këtij aktgjykimit i është zëvendësuar me gjobë dhe atë në shumë prej 3600 euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se i akuzuari refuzon të paguaj këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20 € (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim, i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Me DËNIM PLOTËSUES - konfiskimi i përhershëm sendeve dhe atë, . Shtëpiza F., nr. serik; **2.** Shtëpiza F., nr. serik ...; **3.** Shtëpiza F. nr. serik ...; **4.** Monitor F. nr. serik ...; **5.** Monitor F. nr. serik ...; **6.** Monitor HP nr serik ...; **7.** Aparati për tiketa T. nr. serik ... **8.** Aparati për tiketa ... nr. serik ...; **9.** Letra për tiketa .nr. serik.; ...**10.** Televizor A. nr. serik ...; **11.** Televizor A. nr.serik ...; **12.** Televizor A. nr serik ... **13.** Televizor A. nr serik ...; **14.** Televizor A. nr serik ...; **15.**T. HP nr . serik ... **16.**T. HP nr. serik ...; **17.** T. HP.nr serik ...; **18.** S. O. nr. serik ...; **19.** Te hollat ... euro; **20.** Tiketat e shtypura pa numër serik. detyrohet Agjencia përkatëse për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar në bashkëpunim me policinë e Kosovës që të administrojë këtë pasuri të luajtshme të konfiskuar në pajtim me legjislacionin përkatës.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30€).

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50 €).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr-3919/19 të datës 05.10.2020 (2019:0203735), kundër të pandehurit B. P. nga Vushtrria Rr. “B. B. – A.”, për shkak të veprës penale, Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-se, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 28.01.2021, në këtë seancë të shqyrtimit fillestar i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar se, e pranon fajësinë ne te gjitha pikat e aktakuzës, dhe së është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtojë gjykatës që në të ardhmen që kjo vepër nuk do të përsëritet.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka deklaruar se jam i pajtimit me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të përcaktuar me nenin 248 par .1 dhe i propozoj gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë dhe që pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, i njëjti është penduar thellë për veprën dhe se i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë veprën.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri.

Provat e administruara dhe të vlerësuara në shqyrtimin fillestar

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Raporti i oficerit me nr. 2019-BD-7846 i dt.01.11.2019, Raport policor i hetuesit me nr 2020-BD-760 i dt. 05.11.2020, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dëshmitarit-ankuesit F. A., i datës 29.11.2019, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin B. P. i datës 29.11.2019, Vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me nr.K.I4401, lokacioni në Vushtri, Dosja e Forenzikës (përmbajtja e dosjes, raporti i vendit të ngjarjes, raporti i ekspertimit të datës 22.09.2020, CD ekstraktin nga dosja penale, informacionet e personit mbi të kaluarën kriminale. Andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklarimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e sanksionuar me dënim me gjobë ose me burgim nga (6) muaj deri në (5) vite, gjykata duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë rënduese kjo gjykatë ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tij në kryerjen e veprës penale, dëmin e shkaktuar në raport me personat që krijojnë varësi nga këto lojëra dhe pasojat që shkaktohen në familje dhe shoqëri si rezultat i këtyre lojërave dhe involvimit të tyre, si dhe i njëjti edhe më parë ka qenë i gjykuar me aktgjykimin P.nr.173/2006, të datës 04.05.2007, të gjitha këto rrethana konsistojnë në inkriminimin e të pandehurit në kryerjen e kësaj veprë penale. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri ka bashkëpunuar me gjykatën, është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë si dhe ka pranuar fajësinë, si dhe rrethanat familjare i njëjti është mbajtës i familjes.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale. Vendimin mbi konfiskimin e përhershëm të sendeve me të cilat është kryer vepra penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 283 par.1 të KPPK-së, ku është përcaktuar se: “ *Para se gjykata të jep urdhërin përfundimtar për konfiskimin penal të ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme apo asetit të përcaktuar në aktakuzë, në aktakuzë duhet të pretendohet dhe prokurori i shtetit duhet të provojë në shqyrtim gjyqësor se ndërtesa, sendi i paluajtshëm, sendi i luajtshëm ose asetit është përdorur në kryerjen e veprës penale* ”.

Arsyet lidhur me vendimin për kompensimin të viktimave të krimit dhe paushallit gjyqësor

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.643/2020, datë: 03.02.2021

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.